



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Datë: 27.10.2025
Numër Protokolli: 6994/2025

A.nr.1684/2025

Këshilli i Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti, kryetar, Eshref Shabani dhe Ardita Haxhnikaj-Demi, anëtarë, me Avdyll Bekteshi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurën sipas ankesës A.nr.1684/2025, të datës 11.09.2025, të parashtruar nga ankuesja R.O të cilën me autorizim e përfaqëson Avokat Dren Kukaj nga Prishtina, kundër organit të punësimit: Qendrës së Studentëve, në çështjen juridike “*Masë disiplinore*”, duke vepruar në pajtim me Nenin 6, paragrafin 1 nën, paragrafin 1.1, Nenin 16, paragrafin 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 27.10.2025, mori këtë:

V E N D I M

- I.** Këshilli i Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, *shpallet jo kompetent* për të vendosur lidhur me ankesën A.nr.1684/2025, të datës 11.09.2025, të parashtruar nga ankuesja R.O.
- II.** Pala udhëzohet për mjetin juridik në Gjykatën Kompetente për Çështje Administrative.

A r s y e t i m

Ankuesja R.O (*me tej referuar vetëm ankuesi*), me datë 09.09.2025, përmes postës, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e regjistruar më datë 11.09.2025, nën shenjen A.nr.1684/2025, ndaj Vendimit me numër 837/01.09.2025 të datës 01.09.2025, të Komisionit Disiplinor të Qendrës së Studentëve.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit të shkresave të lëndës konstaton se Këshilli i Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës nuk është kompetent për të vendosur për ankesën e parashtruar nga ankuesja, **sepse**:

Nga provat e lëndës rrjedhë se Komisioni Disiplinor i Qendrës së Studentëve më datë 01.09.2025 ka nxjerr Vendim me numër 837/01.09.2025, me të cilin ankueses i ka shqiptuar masën disiplinore “*Transferim në pozitë me koeficient të njëjtë*”, duke e udhëzuar të njëjtën sipas *këshillës juridike: kundër këtij vendimi papa*

e pakënaqur mund të ankohet në Komisionin për Ankesa në kuadër të Qendrës së Studentëve në afat prej 15 ditëve.

Në kuptim të përcaktimit të kompetencës së Këshillit lidhur me këtë çështje administrative, Kolegji i Këshillit iu referua Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë, gjegjësisht nenit 5 më të cilin përcaktohet se: *Kategoritë e zyrtarës/it publik janë: 1.1. Nëpunësja/i i shërbimit civil; 1.2. Nëpunësja/i i shërbimit publik; 1.3. Krijuesja/i dhe performuesja/i e/i artit dhe kulturës; 1.4. Nëpunësja/i teknik dhe mbështetës; dhe 1.5. Zyrtarja/i i kabinetit. 2. Nëpunësja/i i shërbimit civil është zyrtarja/i publik në kuadër të shërbimit civil i cili merr pjesë në formulimin dhe/apo zbatimin e politikave, monitorimin e zbatimit të rregullave dhe procedurave administrative dhe ofrimin e mbështetjes së përgjithshme profesionale dhe administrative në zbatim. Nëpunësja/i i shërbimit civil ushtron detyrën në pozitën përkatëse, duke filluar nga zyrtarja/i profesional deri në pozitën e drejtueses/it të lartë, në administratën e Presidentes/it të Republikës së Kosovës, në administratën e Kuvendit të Republikës së Kosovës, në Zyrën e Kryeministres/it të Republikës së Kosovës, në Ministri, në Agjenci Ekzekutive dhe në degë lokale të tyre, institucione të pavarura kushtetuese, në agjenci të pavarura dhe rregullatore, në administratën komunale dhe çdo nëpunës/ës statusi i të cilit është përcaktuar si nëpunës/ës i shërbimit civil, me ligj të veçantë. 3. Nëpunësja/i i shërbimit publik është zyrtarja/i publik i cili ofron shërbime publike të drejtpërdrejta për qytetarët në fushën e arsimit, shëndetësisë, kulturës, artit, në fushën e mjekësisë ligjore, si dhe shërbime tjera të ngjashme publike. Nëpunësja/i i shërbimit publik ushtron detyrën në pozitën përkatëse duke filluar nga niveli profesional deri në nivelin e lartë drejtues. Nëpunësja/i i shërbimit publik është edhe nëpunësja/i i shërbimeve të brendshme në administratën e shërbimeve publike pjesë e administratës shtetërore, në administratën e shërbimeve publike apo pjesë e komunës....”.*

Rrjedhimisht në kuptim të këtyre dispozitave ligjore rezulton se Qendra e Studentëve, përfshirë zyrtarët e nivelit të lartë drejtues, drejtues, profesional dhe shërbimeve të brendshme kanë statusin e nëpunësit të shërbimit publikë, andaj duke qenë se me ankesë kontestohet Vendimi me numër 837/01.09.2025 i datës 01.09.2025 i Komisionit Disiplinor të Qendrës së Studentëve, atëherë Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk ka kompetenca lëndore për të vendosur lidhur me ankesën me numër A.nr.1684/2025, sepse, duke u bazuar në nenin 6, paragrafi 1, nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës është kompetent për të shqyrtuar vetëm ankesat e nëpunësve civilë dhe kandidatëve për pranim në Shërbimin Civil, ndërsa nëpunësit e shërbimit publik sipas nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-294 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik, me të cilin nenit 27 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik i është shtuar paragrafi 6,ku përcaktohet: *“Nëpunësi i shërbimit publik dhe nëpunësi teknik dhe mbështetës kanë të drejtë të parashitrojnë ankesë tek Komisioni i Ankesave i themeluar nga punëdhënësi, për çdo veprim apo mosveprim që i cenon të drejtat apo interesat e ligjshme që burojnë nga marrëdhënia e punës. Qeveria pas propozimit të ministrisë përgjegjëse për administratë publike, me akt nënligjor përcakton procedurën dhe rregullat për themelimin, përbërjen dhe mandatin e Komisionit të Ankesave”*, pra nga kjo dispozitë e potencuar si më lartë të njëjtit kanë të drejtë të parashitrojnë ankesë te Komisioni i Ankesave pastaj në gjykatën kompetente.

Në kuptim të së drejtës së palës ankuese në mjete juridike si e drejtë kushtetuese dhe ligjore, Kolegji vë në dukje përcaktimet ligjore sipas nenit 77 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë, ku parashihet se: *Neni 77, paragrafi 1: 1. Përveç kur parashikohet shprehimisht ndryshe në këtë pjesë të ligjit, marrëdhënia e punës për nëpunësin/in e shërbimit publik rregullohet sipas dispozitave të Ligjit përkatës të Punës...”* e në

ndërlidhje me këtë Ligji Nr. 03/L-212 i Punës përkatësisht me nenin 78 dhe 79 ka përcaktuar: Neni 79, paragrafi 1 dhe " 1. I punësuar i cili vlerëson se punëdhënësi ka shkelur të drejtën e marrëdhënies së punës, mund të paraqesë kërkesë te punëdhënësi apo organi përkatës i punëdhënësit nëse ekziston, për realizimin e të drejtave të shkelura. 2. Punëdhënësi është i obliguar për të vendosur sipas kërkesës së të punësuarit, në afatin brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga data e pranimi të kërkesës. Neni 79 paragrafi 1: Çdo i punësuar i cili nuk është i kënaqur me vendimin me të cilin mendon se i janë shkelur të drejtat e tij, ose nuk merr përgjigje brenda afatit nga neni 78 paragrafi 2. të këtij ligji, në afatin vijues prej tridhjetë (30) ditësh, mund të inicioj kontest pune në Gjykatën Kompetente .

Marr parasysh konstatimin si me lartë se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk ka juridiksion apo kompetencë lëndore për të vendosur lidhur me ankesën A.nr.1684/2025, dhe meqenëse nga shkresat e lëndës konstatohet fakti se Komisioni i Ankesave i Qendrës së Studentëve më datë 25.09.2025 ka nxjerr Vendim me Nr. 917, me të cilin ka refuzuar ankesën e palës ankuese, duke dhënë këshillën juridike: *pala e pakënaqur kundër vendimit të marr nga Komisioni i ankesave, mund të inicioj kontest pune në gjykatën kompetente për çështje administrative*, atëherë pala udhëzohet për kontest në këtë gjykatë.

Bazuar si më sipër, e në mbështetje të nenit 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr.06/L048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës si dhe Ligjit Nr. 08/L-294 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda,A.nr.1684/2025, datë 27/10/2025

Avdyl BEKTESHI

Procesmbajtës

Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Përfaqësuesit të autorizuar të ankueses Avokat Dren Kukaj;
- Organit të punësimit: Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Qendrën e Studentëve; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.